



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 524/4 Prot

Tiranë, më 15.06.2016

VENDIM

Nr. 31 .datë 15.06.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "*Petro Nako*" Sarandë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 06.05.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "*Petro Nako*" Sarandë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Spitali Sarandë "*Petro Nako*", i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale;
2. Kontrolluesi nuk ka një rregullore specifike për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit "*Deklaratën e Konfidencialitetit*". Konstatohet se ruajtja e konfidencialitetit nuk është parashikuar as në rregulloren për funksionimin e spitalit po ashtu dhe në kontratat individuale me punëmarrësit;
4. Kontrolluesi nuk nënshkruan kontratë me palët e treta të cilat kontraktohen për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, as në funksion të shërbimeve që kryhen dhe as në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 22, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Vendimit nr. 6 "*Për*

përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” si dhe Udhëzimin nr. 23 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

Për shkeljet e konstatuara, është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 25.05.2016, në të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime.

Në zbatim të neneve 87-88 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 13.06.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti pretendimet e mëposhtme:

- 1) Mbas kontrollit të ushtruar nga inspektorët e Zyrës së Komisionerit dhe njohjes me detyrimet ligjore përkatëse, është realizuar “Njoftimi” në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
- 2) Është ngritur një grup pune me qëllim hartimin e rregullores specifike “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe nënshkrimin e “Deklaratës së Konfidencialitetit” nga punëmarrësit e kontrolluesit.

Nga verifikimi i kryer në protokollin e Zyrës së Komisionerit u konstatua se kontrolluesi ka “Njoftuar” në lidhje me përpunimin e të dhënave nëpërmjet shkresës nr. 655 prot., datë 07/06/2016.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika “I”, shkronja “dh” e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë “kundërvajtje administrative” dhe sanksionohen me gjobë.

- “dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.”

Kontrolluesi Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali “Petro Nako” Sarandë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën “I” të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave “pacientë”.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 27, 28, 39/1 shkronja "dh" dhe 39/2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "Petro Nako" Sarandë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "Petro Nako" Sarandë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "Petro Nako" Sarandë, të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me "Deklaratat e Konfidencialitetit" sipas Vendimit nr.6, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 30 ditësh.
4. Kontrolluesi Drejtoria e Shërbimit Spitalor - Spitali "Petro Nako" Sarandë, të realizojë aneks kontratën tip të konfidencialitetit sipas Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga palët e treta me të cilat kontraktin për kryerjen e shërbimeve që ata ofrojnë, e për pasojë, aksesojnë të dhënat e pacientëve të kontrolluesit si dhe të zbatojë Udhëzimin nr. 23 të Komisionerit, datë 20.11.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë".
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 15.06.2016

Bësnik DERVISHI

KOMISIONERI